

**Shtojca nr.2**  
**Raporti i ndërmjetëm i Monitoruesve**

**I. Përmbledhje**

<b>Vëzhguesi:</b> <b>(Emri, mbiemri)</b>	
<b>Rajoni/ Komuna e monitoruar:</b>	Bashkia Kamëz, Zona administrative Paskuqan. Bashkia Vorë, Zonat Administrative Bërxullë, Prezë,
<b>Subjektet zgjedhore të monitoruar:</b>	Partia Demokratike Flamur Noka , Partia Socialiste Elisa Spiropali , Partia Social Demokrate, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim.
<b>Periudha e mbuluar nga raporti:</b>	10.03.2021-20.03.2021
<b>Data e dorëzimit të raportit:</b>	20.03.2021
<b>Nënshkrimi</b>	

Shënim: për Seksionin II (monitorimi i aktiviteteve të fushatës), një raport monitorimi i veçantë duhet të plotësohet për secilin subjekt zgjedhor, duke përdorur formularin e dhënë. Për seksionin III (monitorimi i abuzimit/ keqpërdorimit të burimeve shtetërore), një raport duhet të plotësohet për të gjithë zonën gjeografike të monitoruar.

## **II. SUBJEKTI ZGJEDHOR –AKTIVITETET E MONITORUARA TË FUSHATËS**

**Një raport monitorimi i veçantë duhet të plotësohet për secilin subjekt zgjedhor, duke përdorur formularin e mëposhtëm.**

Raporti i Monitorimit për Subjektin Zgjedhor <b><u>Partia Demokratike (PD)</u></b> (shtoni emrin e subjektit zgjedhor)
--

Raporti i Monitorimit për Subjektin Zgjedhor <b><u>Partia Socialiste (PS)</u></b> ( Shtoni emrin e subjektit zgjedhor)
--

Raporti i Monitorimit për Subjektin Zgjedhor <b><u>Partia Social Demokrate (PSD)</u></b> ( shtoni emrin e subjektit zgjedhor)
---

Raporti i Monitorimit për Subjektin Zgjedhor <b><u>Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI)</u></b> (shtoni emrin e subjektit zgjedhor)
---

## 1. Përmbledhja e aktiviteteve të monitoruara të subjektit zgjedhor

Lloji i aktivitetit të monitoruar	Detaje	Parregullsi për tu përmendur këtu dhe për tu identifikuar më vonë
a) Zyrat elektorale	Numri dhe vendndodhja e zyrave elektorale të monitoruara	Po/ Jo
(PD)	5 zyra elektorale	
(PS)	3 zyra elektorale	
(LSI)	1 zyrë elektorale	
(PSD)	0 Zyra elektorale	
b) Ngjarjet e Fushatës	Numri i aktiviteteve të monitoruara të fushatës të organizuara nga subjekti zgjedhor të cilat u monitoruan	Po/ Jo
(PD)	14 Aktivitete	
(PS)	17 Aktivitete	
(LSI)	5 Aktivitete	
c) Materialet propagandistike	Numri i materialeve të monitoruara (të bashkangjiten mostra/foto për secilen)	Po/ Jo
Banderola	Numri i materialeve vizive propagandistike të shqyrtuara për përfshirjen e shënimit: 'Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të ...'	Po/ Jo
d) Monitorimi i Faqeve te Internetit	Identifikimi i platformave të faqeve të internetit Flamur Noka (PD) Elisa Spiropali (PS) LSI kamzë	Po/ Jo

## 2. Detaje të aktiviteteve të monitoruara të subjektit zgjedhor

a) Zyrat elektorale

#	Vendndodhja/Adresa	Madhësia	Detaje të tjera (pajisje teknike, <del>kos</del> toja e qerasë materiale promocionale, materiale të printuara etj.)
1	(PD) Kamzë, Paskuqan/ Rr. Halit Haxhia	40 m2	Printer, kompjuter, Xhamat e veshura me siglën e partisë.
2	(PD) Kamzë, Paskuqan/ Rr. Ilmi Kolgjeka	120 m2	Printer, kompjuter, Xhamat e veshura me siglën e partisë.
3	(PD) Bërxullë	Ska	Ska
4	(PD) Prezë	Ska	Ska
5	(PD) Vorë/ Te. Sadi Vorpsi	100 m2	Printer, kompjuter, Xhamat e veshura me siglën e partisë.
6	(PS) Kamzë, Paskuqan/ Rr. Halit Haxhia	60 m2	Printer, kompjuter, Xhamat e veshura me siglën e partisë.
7	(PS) Bërxullë/ Ska	Ska	Ska
8	(PS) Prezë/ Në qendër te kalaja.	40 m2	Printer, kompjuter, Xhamat e veshura me siglën e partisë.
9	(PS) Vorë/ Rr. Rinia	120 m2	Printer, kompjuter, Xhamat e veshura me siglën e partisë.

10	(PSD) Kamzë, Paskuqan/ Rr. Unaza e Madhe.	80 m2	Printer, kompjuter, Xhamat e veshura me siglën e partisë.
11	(PSD) Bërxullë/ Ska	Ska	Ska
12	(PSD) Prezë/ Ska	Ska	Ska
13	(PSD) Vorë/ Rr. Rinia	120 m2	Printer, kompjuter, Xhamat e veshura me siglën e partisë.
14	(LSI) Kamzë, Paskuqan/ Ska	Ska	Ska
15	(LSI) Bërxullë/ S'ka	S'ka	S'ka
16	(LSI) Prezë/ S'ka	S'ka	S'ka
17	(LSI) Vorë/ S'ka	S'ka	S'ka

b) Aktivitetet e Fushatës

#	Vendndodhja	Ora dhe Data	Nr. i të pranishëmve	Detaje të tjera (pajisje teknike, materialet e fushatës etj.)
1	(PD) Bashkia Kamëz	Ora: 17:00 Data: 10/03/2021	Reth 20 Qytetarë. Këtu përfshihen stafi, dhe qytetarët që bashkëbisedon me përfaqësuesin politik. Në zyrën e partisë demokratike të degës Kamëz.	Materialet e Siglës së Partisë Demokratike në fund të videos.
2	(PD) Bashkia Kamëz Në kalçeto.	Ora: 19:00 Data: 15/03/2021	27 qytetarë. Këtu përfshihen të rinj dhe të	Mesazhi i kandidatit të partisë demokratike me sfond blu, dhe fotot nga aktiviteti i organizuar.

			reja , dhe përfaqësuesi politik i partisë demokratike.	
3	(PD) Bashkia Kamëz, Paskuqan, në sheshin e një prej Lagjeve.	Ora 11:20 Data 15/03/2021	50 persona. Këtu përfshihen stafi dhe qytetarët që dëgjojnë platformën e përfaqësuesit politik.	Posteri i Partisë Demokratike mbrapa podiumit.
4	(PD) Bashkia Kamëz,	Ora 13:00 Data 15/03/2021	100 qytetarë. Këtu përfshihen stafi dhe qytetarët që ecin bashkë me kryetarin e partisë demokratike dhe kandidatin për deputet.	Kamera që ndjekin aktivitetin për t'a transmetuar në mediat sociale Facebook.
5	(PD) Bashkia Kamëz, Paskuqan	Ora 11:52 Data 17/03/2021	Reth 20 qytetarë. Kandidati për deputet dhe stafi i tij. Dhe disa qytetarë që bashkëbisedojnë me të.	Kamera që e ndjekin takimin për të hedhur fotot e takimeve në mediat sociale.
6	(PD) Bashkia Kamzë, Paskuqan, Kodra e kuqe	Ora 1:00 P.M Data 18/03/2021	Reth 30 qytetarë. Kandidati për deputet dhe stafi i tij. Dhe qytetarë që bashkëbisedojnë me të.	Kamera që e ndjekin takimin për të hedhur fotot e takimeve në mediat sociale.
7	(PD) Bashkia Kamzë, Paskuqan.	Ora 5.22 P.M Data 19/03/2021	Reth 10 qytetarë. Kandidati për deputet dhe stafi i tij. Dhe qytetarë që kanë bizneset e të tyre. Dhe që bashkëbisedojnë me të.	Kamera që e ndjekin takimin për të hedhur fotot e takimeve në mediat sociale.

8	(PD) Bërxullë	S'ka aktivitete	S'ka aktivitete	S'ka aktivitete
9	(PD) Prezë	S'ka aktivitete	S'ka aktivitete	S'ka aktivitete
10	(PD) Vorë/ qendër vorë	Ora: 12:00P.M Data 11/03/2021	Kandidati për deputet dhe stafi i tij.	Kamera për xhirimin e fjalimit, për ta hedhur në mediat sociale.
11	(PD) Vorë/ Marikaj	Ora 11:00 Data: 11/03/2021	Rreth 5 qytetarë. Kandidati për deputet dhe stafi i tij. Dhe dy pjesëtarët e një familjeje që ka ngelur në çadër pas tërmetit.	Kamera për xhirimin e takimit të tyre, në çadër. Dhe për t'a hedhur më pas në Rrjetet Sociale.
12	(PD) Vorë/Marikaj në familjen e Zaim Gegës	Ora 18:00 Data 14/03/2021	Reth 3 qytetarë. Përfshirë këtu dhe Kryefamiljarin , deputetin, dhe stafin e tij.	Kamera për xhirimin e takimit me kryefamiljarin në nevojë. Dhe për t'a hedhur në mediat sociale.
13	(PD) Vorë/Marikaj, qendër.	Ora 15:00 Data 14/03/2021	Kandidati për deputet dhe stafi i tij.	Kamera për xhirimin e fjalimit të tij. Dhe për ta hedhur në mediat sociale.
14	(PD) Vorë/ Qendër	Ora 11:00 Data 15/03/2021	Reth 40 qytetarë, ku përfshihen qytetarë të Vorës, kandidati për deputet dhe stafi i tij. Kryetari i partisë demokratike të Shqipërisë dhe stafi i tij.	Kamera për xhirimin e takimit të tij dhe për ta hedhur në mediat sociale, dhe televizione.
15	(PD) Vorë/ Marikaj	Ora 12:00 Data 15/03/2021	Reth 10 qytetarë, ku përfshihen dy familjare, kandidati për deputet dhe kryetari i partisë demokratike të Shqipërisë.	Kamera për xhirimin e takimit të tij me ta. Dhe për ta hedhur në mediat sociale, dhe televizione.

16	(PD) Vorë/ në Biznesin e AZS Albania	Ora 6:53 P.M Data 18.03.2021	Rreth 6 qytetarë, ku përfshihen: dy administratorët e kompanisë; kandidati për deputet i partisë demokratike, stafi i tij, si dhe Jorida Tabaku.	Kamera për xhirimin e takimit të tyre. Dhe për ta hedhur në mediat sociale ose televizione.
17	(PSD) Kamzë/Paskuqan	S'ka Aktivitete	S'ka Aktivitete	S'ka Aktivitete
18	(PSD) Bërçullë	S'ka Aktivitete	S'ka Aktivitete	S'ka Aktivitete
19	(PSD) Prezë	S'ka Aktivitete	S'ka Aktivitete	S'ka Aktivitete
20	(PSD) Vorë	S'ka Aktivitete	S'ka Aktivitete	S'ka Aktivitete
21	(LSI) Kamzë/ Troci Business Centre, Rr. Demokracia	Ora 17:00 P.M Data 10/03/2021	Reth 6 qytetarë, Anëtarë të skuadrës së LSI Kamzë.	Kamera për bërjen e fotografive, dhe dy Banderola.
22	(LSI) Kamzë / Troci Business Centre, Rr. Demokracia	Ora 18:00 P.M Data 11/03/2021	Reth 4 qytetarë, Anëtarë të skuadrës së LSI Kamzë.	Kamera për bërjen e fotografive nga takimi.
23	(LSI) Kamzë/ Troci Business Centre, Rr. Demokracia	Ora 17:41 P.M Data 14/03/2021	Reth 25 qytetarë, anëtarë ( të rinj dhe të reja nga stafi i LRI Kamzë).	Kamera për bërjen e fotografive nga mbledhja e LRI Kamzë. Dhe dy Banderola me Logot e partisë Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI).
24	(LSI) Kamzë/ Troci Business Centre, Rr. Demokracia	Ora 18:00 P.M Data 15/03/2021	Reth 14 qytetarë, anëtarë (të rinj dhe të reja nga stafi i LRI Kamzë).	Kamera për bërjen e fotografive nga mbledhja e LRI Kamzë. Dhe dy Banderola me Logot e partisë Lëvizja Socialiste për Integrim LSI, në Sfond.



25	(LSI) Kamzë/ Troci Business Centre, Rr. Demokracia	Ora 19:00 P.M Data 16/03/2021	Reth 18 Qytetarë anëtarë të Skuadrës Së LSI Kamzë.	Kamera për bërjen e fotografive dhe videove nga mbledhja Anëtarëve të LSI Kamzë. Logot e partisë Lëvizja Socialiste për Integrim LSI në Sfond.
26	(LSI) Bërxullë	S'ka Aktivitete	S'ka Pjesëmarrës	S'ka Aktivitete
27	(LSI) Prezë	S'ka Aktivitete	S'ka Pjesëmarrës	S'ka Aktivitete
28	(LSI) Vorë	S'ka Aktivitete	S'ka Pjesëmarrës	S'ka Aktivitete
29	(PS) Kamzë/ Qendër	Ora 10:00 Data 12/03/2021	Reth 25 Qytetarë përfshirë këtu edhe Kandidatën e partisë socialiste dhe stafin e saj.	Kamera për bërjen e fotografive nga takimi me qytetarët e Kamzës. Dhe postimin e tyre në mediat sociale.
30	(PS) Kamzë	Ora 5:54 e pasdites Data 12/03/2021	Reth 14 qytetarë, të rinj dhe të reja të partisë socialiste Kamzë. Si dhe kandidatës së partisë socialiste Kamzë.	Kamera për bërjen e fotografive nga takimi me qytetarët, dhe postimin e tyre në mediat sociale.
31	(PS) Kamzë/Qendër kamzë	Ora 13:00 e Pasdites Data 12/03/2021	Rreth 10 qytetarë, përfshirë në të dy të zotët e shtëpive që po ndërtohen kandidatën e partisë socialiste Kamzë, dhe stafin e saj. Si dhe kryetarin e Bashkisë Kamzë.	Kamera për bërjen e fotografive dhe videove nga takimi me banorët e shtëpive që janë duke u ndërtuar. Dhe postimin e tyre në mediat sociale.
32	(PS) Kamzë/ Tregu i Kamzës	Ora 11:00 A.M Data 13/03/2021	Rreth 20 qytetarë tregtarë , dhe kandidatja e partisë socialiste Kamzë, së bashku me kryetarin e	Kamera për bërjen E fotografive, nga takimi me tregtarët e tregut të Kamzës. Dhe postimin e tyre në mediat sociale.

			Bashkisë Kamzë, dhe stafin e saj.	
33	(PS) Kamzë/ Laknas në kantier rrugësh	Ora 16:53 P.M Data 13/03/2021	Reth 15 qytetarë ku përfshihen: punëtorët e rrugëve, kandidatja e partisë socialiste Kamzë, si dhe stafin e saj, përfshirë në të dhe kryetarin e Bashkisë Kamzë.	Kamera për bërjen e fotografive nga takimi me punëtorët dhe inxhinierët e rrugës. Dhe postimin e tyre në mediat sociale.
33	(PS) Kamzë/ në kalçeto	Ora 10:00 Data 14/03/2021	Rreth 15 qytetarë nga strukturat e Freshit, përfshirë edhe Kanditen e partisë socialiste Kamzë si dhe kryetarin e Bashkisë Kamzë.	Kamera për bërjen e fotografive nga takimi me të rinjtë e partisë socialiste Kamzë. Dhe postimin e tyre në mediat sociale.
37	(PS) Kamzë/ Paskuqan	Ora 19:00 P.M Data 16/03/2021	Reth 4 qytetarë, Takim me një qytetar të Paskuqanit, dhe xhirimin e një video selfie për Presidentin e republikës Ilir Meta.	Telefoni i kandidatës së partisë socialiste Kamzë. Për bërjen e videos. Dhe postimin e saj në mediat sociale.
38	(PS) Kamzë/ Babru kodër	Ora 11:00 A.M Data 17/03/2021	Rreth 20 qytetarë, banorë të zonës. Si dhe kandidatja për deputete e partisë socialiste Kamzë, dhe kryetari i bashkisë Kamzë.	Kamera për bërjen e fotografive nga takimi me banorët e zonës. Dhe postimin e tyre në mediat sociale.
39	(PS) Kamzë/ Babru Kodër	Ora 6:41 P.M Data 18/03/2021	Reth 20 qytetarë, Banorë të zonës. Inxhinier, Kandidatja për deputete e	Video kamera për bërjen e videos së aktivitetit, Dhe postimin e saj në Mediat Sociale.

			partisë socialiste, si dhe kryetari i bashkisë Kamzë.	
40	(PS) Kamzë	Ora 3:00 P.M Data 18/03/2021	Reth 15 Qytetarë, të rinj dhe të reja të strukturës së Freshit. Si dhe kandidatja për deputete e partisë socialiste Kamzë.	Kamera për bërjen e fotografive nga takimi me të rinjtë e partisë socialiste Kamzë, Banderola me Logot e partisë socialiste Kamzë. Dhe postimin e tyre në mediat sociale.
41	(PS) Kamzë/Dolce&Salary Pranë shkollës profesionale në Kamzë, Rr. Montreal	Ora 11.00 A.M Data 19/03/2021	Reth 10 qytetarë, përfshirë në të punëtore, administratorët, Kandidaten për deputete e partisë socialiste Kamzë. Si dhe kryetarin e Bashkisë Kamzë.	Kamera për bërjen e videos nga takimi me punëtorët dhe administratorët e kompanisë, si dhe marjen pjesë në procesin e punës. Dhe postimin e saj në Mediat Sociale.
42	(PS) Kamzë/ Lagja e shkollës profesionale, Rr. Montreal	Ora 10:00 A.M Data 19/03/2021	Reth 20 qytetarë të Kamzës, përfshirë në të biznesmenë të zonës dhe stafin e kandidatës së partisë socialiste Kamzë dhe kryetarin e Bashkisë Kamzë.	Kamera për bërjen e fotografive nga takimi me biznesmenët dhe kandidatës së partisë socialiste Kamzë. Dhe postimin e tyre në mediat sociale.
43	(PS) Kamzë/ Lagja e shkollës profesionale, Rr. Montreal	Ora 9:14 A.M Data 19/03/2021	Reth 20 qytetare të Kamzës, përfshirë në të përfaqësuesen politike të partisë socialiste Kamzë dhe stafin e saj, si dhe kryetarin e Bashkisë Kamzë.	Kamera për bërjen e fotografive nga takimi me gratë dhe vajzat e Lagjes së shkollës profesionale. Për postimi e tyre në mediat sociale. Dhe Banderola me Logot e partisë socialiste.

44	(PS) Kamzë/ Shkolla Ibrahim Rugova, Rr. Bulevardi Blu.	Ora 11:00 A.M Data 19/03/2021	Rreth 25 Qytetarë të Kamzës, përfshirë në të mësues dhe mësuese, drejtuesit e shkollës, stafin mjekësor, dhe kandidaten për deputete të partisë socialiste Kamzë.	Kamera për bërjen e fotografive nga aktiviteti i zhvilluar, dhe postimi i tyre në mediat sociale.
45	(PS) Kamzë/ Valias i vjetër	Ora 17:25 P.M Data 19/03/2021	Rreth 5 qytetarë të Kamzës, përfshirë në të pjesëtarë të familjes: Xhemali dhe kandidates për deputet të partisë socialiste Kamzë.	Kamera për bërjen e fotografive nga takimi me familjen Xhemali. Dhe postimin e tyre në mediat sociale.
46	(PS) Kamzë/Kamza e re	Ora 16:00 P.M Data 19.03.2021	Rreth 40 qytetare të Kamzës përfshirë në të gra dhe vajza të Kamzës së re. Dhe Kandidates së partisë socialiste Kamzë dhe stafin e saj.	Banderola me logon e partisë socialiste, dhe kamera për fotografimin e aktiviteti të zhvilluar. Dhe postimin e tyre në mediat sociale.
47	(PS) Kamzë/Valias	Ora 16:30 P.M Data 19:03:2021	Rreth 40 qytetarë dhe qytetare të Valiasit. Përfshirë në të rinj dhe të reja, pensionist dhe pensioniste. Si dhe kandidaten e partisë socialiste Kamzë dhe stafin e saj.	Kamera për bërjen e fotografive nga takimi me banorët e zonës së Valiasit dhe postimin e tyre në mediat sociale.
48	(PS) Bërxullë	S'ka Aktivitete	S'ka Aktivitete	S'ka Aktivitete
49	(PS) Prezë	S'ka Aktivitete	S'ka Aktivitete	S'ka Aktivitete

50	(PS) Vorë	S'ka Aktivitete	S'ka Aktivitete	S'ka Aktivitete
----	-----------	-----------------	-----------------	-----------------

c) Materialet Propagandistike

#	Lloji i materialeve propagandistike	Përfshirja e shënimit: "Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të ...."	Përshkrimi (madhësia, materiali, cilësia...)
1	(PD) Flamur të Partisë Demokratike dhe, të shtetit.	-	Madhësia e tyre janë: flamuri 2 m me 1 m.
2	(PD) Postera të partisë demokratike në fund të tribunës.	-	Posteri në fund të skenës është 3 m me 2 m.
3	(PD) Mesazhet e partisë demokratike në rrjetet sociale, mbi sfond blu.	S'ka	S'ka

4	(PSD) Ska	S'ka	S'ka
5	(LSI) Banderola të partisë Lëvizja Socialiste për Integrim	S'ka	Madhësia e tyre janë: Banderola: 3m me 1 m
6	(LSI) Logo e partisë Lëvizja Socialiste për Integrim	S'ka	Madhësia e tyre janë: 12m2.
7	(PS) Banderola të partisë socialiste	S'ka	Madhësia e tyre janë 4m2
8	(PS) Logo të partisë socialiste	S'ka	Madhësia e tyre janë, 10m2, 15m2, 20m2

d) Rrjetet Sociale







#	Platforma	Dita e postimit/ reklamës	Llogaria	Detaje të tjera (përmbajtja, audiencia e synuar.)
1	Facebook	10/03/2021	Flamur Noka	<p>Përmbajtja: mbledhje me të rinjtë e partisë demokratike Kamzë. Në të cilën u shpërndanë disa anëtarësime të reja për të rinj dhe të reja që vijjnë për herë të parë në partinë demokratike.</p> <p>Audiencia e synuar:</p>

				Janë të rinjë dhe të reja të Bashkisë Kamzë.
2	Facebook A2 CNN	11/03/2021	Flamur Noka	<p>Përmbajtja: Takim me banorët e zonës së Bathores. Në të cilën i dëgjuan problemet e banorëve dhe, i premtuan zgjidhje të problemeve nëpërmjet rritjes së rrogave, dhe hapjes së shumë vendeve të punës.</p> <p>Audienca e synuar: Janë Qytetarët e Bathores dhe të Kamzës. Të cilët mund të besojnë te disa nga pikat e përfolura më sipër.</p>
3	Facebook	15/03/2021	Flamur Noka	<p>Përmbajtja: Takim me të rinjtë sportistë të Kamzës. Në të cilën i diskutuan për problemet dhe shqetësimet që ato kanë.</p> <p>Audienca e synuar: Janë të rinjtë, e Kamzës si dhe të zonave të tjera elektorale.</p>
4	Facebook	15/03/2021	Flamur Noka	<p>Përmbajtja: Takim me banorët e Paskuqanit, në të cilën kandidati i PD-së diskuton për problemet që ka zona, dhe zgjidhjen e tyre.</p> <p>Audienca e synuar: Banorët e Paskuqanit.</p>

5	Facebook	16/03/2021	Flamur Noka	<p>Përmbajtja:  Takim i Kryetarit të partisë demokratike të Shqipërisë dhe, kandidatit të partisë demokratike me qytetarë dhe Biznesmenë të Kamzës.  Audiencia e synuar:  Janë qytetarë dhe Biznesmenë të Kamzës.</p>
6	Facebook	17/03/2021	Flamur Noka	<p>Përmbajtja:  Sekserët e Rilindjes kanë nisur aksionin e shitjes së çertifikatave të legalizimit në këmbim të votave.  Një tjetër fenomen skandaloz është edhe abuzimi që po bëhet me paratë e rindërtimit.  Edhe sot, 2 vite pas tërmetit, zuzarë e oborrtarë të pushtetit shkojnë në shtëpitë e dëmtuara të qytetarëve me pretekstin se do të bëjmë vlerësimin e dëmeve dhe premtojnë para për dëmshpërblimin.  Të gjithë këta bataçinjtë që ndër marrin akte të tilla kriminale, do të përballen me forcën e ligjit!  Audiencia e synuar:  Janë Qytetarët e Bashkisë Kamzë, dhe Bashkisë Vorë.</p>
7	Facebook	18/03/2021	Flamur Noka	<p>Përmbajtja:  Banorët e Paskuqanit nuk e kanë ndierë mbështetjen e shtetit në këta 8 vjet.  Në çdo bisedë që bëj me ta, më shprehin nevojën për ndryshim!</p>



				<p>Shkoni e votoni dhe së bashku ne do të sjellim ndryshim dhe një të ardhme më të mirë për të gjithë.</p> <p>Audienca e synuar: Janë banorët e Paskuqanit, dhe të gjithë zonave elektorale të kandidatit të Partisë Demokratike.</p>
8	Facebook	18/03/2021	Flamur Noka	<p>Përmbajtja: Takim me banorët e Kodrës së Kuqe në Paskuqan. Në të cilën u dëgjuan problemet dhe shqetësimet e banorëve të zonës.</p> <p>Audienca e synuar: Janë banorët e Kodrës së Kuqe në Paskuqan. Dhe të gjitha zonave elektorale të kandidatit të partisë demokratike.</p>
9	Facebook	19/03/2021	Flamur Noka	<p>Përmbajtja: 📍 Rilindja nuk e kupton dot fushatën elektorale pa blerje dhe vjedhje votash, por nevoja për ndryshim është e evidente në çdo shtëpi shqiptare.</p> <p>▪ Sot shqiptarët duan një qeveri që të kujdeset për ta. Prandaj rruga e vetme që t'ia dalim dhe të korrim sukses, është të votoni PD nën udhëheqjen e Bashës. 🇲🇰 🇲🇰</p> <p>Audienca e Synuar: Janë banorët e të gjithë zonave elektorale të kandidatit të partisë demokratike.</p>

10	Facebook	19/03/2021	Flamur Noka	<p>Përmbajtja:   Shqipëria duhet të shkojë përpara!  Ndryshimin do ta bëjë Partia Demokratike bashkë me aleatët.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Sot, Edi Rama është i pashpresë!  Nevoja për ndryshim është ulëritëse!</li> <li>▫ Më 25 prill, Partia Demokratike dhe aleatët e saj do të korrin një fitore plebishitare!  </li> </ul> <p>Audienca e synuar:  Janë banorët e të gjitha zonave elektorale të kandidatit të partisë demokratike.</p>
11	Facebook	19/03/2021	Flamur Noka	<p>Përmbajtja:  Takim me Banorët e Paskuqanit në të cilën u dëgjuan shqetësimet e banorëve dhe u premtuan, zgjidhje nga kandidati i partisë demokratike.</p> <p>Audienca e synuar:  Janë Banorët e zonës.</p>
12	Facebook	20/03/2021	Flamur Noka	<p>Përmbajtja:   Takim me banorët e Paskuqanit!  </p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ndihem mirë që në këtë fushatë shoh të angazhuar shumë të rinj. Kjo tregon se rinia e do dhe e kërkon me ngulm ndryshimin!</li> <li>▫ Fitorja e Partisë Demokratike dhe aleatëve të saj do të jetë e padiskutueshme më 25 prill!</li> </ul> <p>Audienca e synuar:</p>

				Janë Banorët e zonës së Paskuqanit.
13	Facebook	11/03/2021	Flamur Noka	<p>Përmbajtja:</p> <p>🔗 Skandal/ Rilindja ka lënë fëmijët e Vorës pa shkollë!</p> <p>📍 Banorët e Vorës kanë shprehur shqetësimin e tyre, në lidhje me shembjen e shkollës 9 vjeçare.</p> <p>Pas tërmetit të nëntorit të vitit 2019, ekspertët vendosën që ndërtesa e shkollës nuk kishte pësuar dëme të mëdha dhe nuk duhej shembur. Vetëm pak muaj më vonë, për qëllime korruptive, shkolla u shemb dhe prej një viti nxënësit e saj zhvillojnë mësim nëpër qendra sociale.</p> <p>☐ Sot, në qendër të Vorës, shohim një shesh të shkretuar, ndërkohë që në atë shesh duhet të ishte ndërtuar një shkollë e re!</p> <p>Rilindja nuk kursen asgjë, as institucionet ku fëmijët tanë marrin dije!</p> <p>Më 25 prill, kjo lloj qeverisjeje duhet larguar me votë! 🗳️</p> <p>Me 25 prill, Shqipëria fiton! AL</p> <p>Audienca e synuar:</p>

				Janë të gjithë banorët e Vorës dhe zonave të tjera elektorale.
14	Facebook	11/03/2021	Flamur Noka	<p>Përmbajtja:  Historia e trishtë e një nëne me fëmijë të sëmurë, që prej 2 vitesh jeton në çadër.  “Me këtë qeveri që është, mjerë ne të shkretët”, thirrja e nënës nga Marikaj, që jeton prej gati 2 vjetësh në çadër. Flamur Noka: Më 25 prill, t’i japim vendit një qeveri që kujdeset për njerëzit #ShqipëriaFITON</p> <p>Audienca e synuar:  Janë të gjithë banorët e zonës, dhe të zonave të tjera elektorale, të kandidatit të partisë demokratike.</p>
15	Facebook	13/03/2021	Flamur Noka	<p>Përmbajtja:  🏠 Familja e Zaim Gegës në Marikaj, nuk e ka ndierë asnjëherë dorën e shtetit. Kjo familje jeton në një dhomë në rrezik shembje, ku fatura e dritave vjen 90 mijë lekë, por ndihma ekonomike për kryefamiljarin është vetëm 20 mijë lekë. Zaimi është invalid me 1 këmbë dhe tregon sesi qeveria po e keqtrajton financiarisht.</p> <p><input type="checkbox"/> Do ta ndryshojmë këtë situatë, jo vetëm për familjen e Zaimit, por për të gjitha familjet në nevojë.</p>

				<p>Ne do ta dyfishojmë ndihmën ekonomike, do të marrësh shërbimin shëndetësor që të takon, pa sorolltje si tani.</p> <p>Shqipëria ka ngelur mbrapa këto vjet, por ne, duhet ta ndryshojmë me votë që të ecim përpara. Qytetarët kanë nevojë për një qeveri që të mendojë për njerëzit. Për ata që janë në nevojë si Zaimi duhet një qeveri për njerëzit, që të mendojë për ta.</p> <p>#ShqipëriaFITON AL Audiencia e synuar: Janë Banorët e zonës.</p>
16	Facebook	14/03/2021	Flamur Noka	<p>Përmbajtja:</p> <p><input type="checkbox"/> Edi Rama e ka zhytur Shqipërinë në baltë!</p> <p>Projekti “100 fshatrat” i Rilindjes, rezultoi një mashtrim i madh!</p> <p>Më 25 prill, do të votojmë ndryshimin! 🇸🇰 🇸🇰</p> <p>Audiencia e synuar: janë banorët e zonës elektorale</p>
17	Facebook	15/03/2021	Flamur Noka	<p>#LIVE – Takime me qytetarë e biznese në Vorë #ShqipëriaFITON</p> <p>Së bashku me kryetarin e partisë demokratike të Shqipërisë.</p> <p>Audiencia e synuar janë banorët e Vorës dhe të gjitha zonave elektorale.</p>

18	Facebook	15/03/2021	Flamur Noka	<p><input type="checkbox"/> Edi Rama e ka rrënuar ekonominë e vendit dhe qytetarët vuajnë çdo ditë pasojat e keqkeverisjes.</p> <p><input type="checkbox"/> Më 25 prill, do të sjellim ndryshimin e shumëpritur! 🙌👊</p> <p>#ShqipëriaFITON AL #LulzimBasha – Takime në dy familje në Marikaj dhe në Valias të ri #ShqipëriaFITON Audiencia e synuar janë: banorët e zonës elektorale.</p>
19	Facebook	10/03/2021	Elisa Spiropali	<p>Përmbajtja: Sonte në 20:45 me Çimin dhe shokët e tij 😊 @syrity Audiencia e synuar: Janë Banorët e zonave elektorale të kandidatës së partisë socialiste.</p>
20	Facebook	12/03/2021	Elisa Spiropali	<p>Përmbajtja: K☕fe mëngjesi me pensionistët në Qendër Kamëz. Ditë e mbarë me njerëz të mirë. 🌻 Audiencia e synuar: Janë pensionistët e zonës, dhe të të gjitha zonave elektorale të kandidatës së partisë socialiste.</p>
21	Facebook	12/03/2021	Elisa Spiropali	<p>Përmbajtja: Super ekip 🌟 Foto me ekipin e të rinjve të partisë socialiste Kamzë.</p>

				Audienca e synuar: Janë të rinjtë dhe të rejtat së Kamzës.
22	Facebook	12/03/2021	Elisa Spiropali	Përmbajtja Qendër-Kamëz 🏠 Banesat e dëmtuara nga tërmeti të Sami Carës dhe Ilir Luzit, po #Rindërtohen nga e para, më të forta e më të sigurta.  #SinjëFamilje ❤️ Audienca e synuar: Janë banorët e zonës, dhe të zonave të tjera elektorale, të kandidatës së partisë socialiste.
23	Facebook	13/03/2021	Elisa Spiropali	Përmbajtja ZER 🌀 taksë dhe ZER 🌀 TVSH për biznesin e vogël.  Zerimi i taksave të biznesit të vogël si dhe ulja e taksave vendore është një ndihmë për ekonominë familjare në kohë jo të lehtë. 🙏  *në tregun e Kamzës Audienca e synuar Janë: tregtarët e zonës.
24	Facebook	14/03/2021	Elisa Spiropali	Përmbajtja Laknas 🏠 Rruga "Lura", në lagjen po me të njejtin emër, është një nga arteriet e rrugëve që po ndërtohen me të gjitha standardet, pjesë

				<p>e kantierit të madh të transformimit infrastrukturor në Kamëz.</p> <p>Për të lënë pas kohën e zinjve, ne vazhdojmë projektet madhore për transformimin me rrënjë të kësaj zone. Mandati i tretë me Edi Ramën na duhet që punët e mëdha të mos ndalen 🇲🇰</p> <p>#SkakohëPërPushim 🌞 🏠 Audienca e synuar janë banorët e zonës elektorale të kandidatës së partisë socialiste.</p>
25	Facebook	15/03/2021	Elisa Spiropali	<p>Përmbajtja Gati 🇲🇰</p> <p>Kamza nuk ndalet deri në fitore 🏆</p> <p>Emocione për këtë takim fantastik me çunat dhe gocat e Kamzës. Do të bëjmë gjithçka që jeta e tyre të jetë më e mirë se e prindërve të tyre.</p> <p>Shpura e Mulit, Rimit, Ilirit, Monës, Fatmirit, veglës së tyre Lulit, dreqit dhe të birit, nuk e ndal dot të ardhmen e Kamzës të vijë. Me Edi Ramën. Me njerëzit, për njerëzit.</p> <p>#ShqipëriaeArdhmjajonë ❤️ ✓ #9</p>



				Audienca e synuar janë të rinjtë dhe të rejtat e zonës elektorale të kandidatës së partisë socialiste Kamzë.
26	Facebook	17/03/2021	Elisa Spiropali	Përmbajtja Dëgjojeni mokrarin Ramadan në Paskuqan 😊 Video humoristike duke recituar një poezi për Presidentin Ilir Meta. Audienca e synuar janë banorët e zonës së Paskuqanit.
27	Facebook	17/03/2021	Elisa Spiropali	Përmbajtja Derë më derë në Babrru-kodër, ku rruga kryesore, ndriçimi etj po ndërtohen pas dekadash braktisje nga pushteti lokal. Me njerëzit për njerëzit. #skakohëpërpushim👏 Audienca e synuar janë: banorët e zonës elektorale babru kodër.
18	Facebook	18/03/2021	Elisa Spiropali	Përmbajtja Ndezëm dritat në Babrru- Kodër💡🎯 ndezja e dritave të rrugës së re. Audienca: janë banorët e zonës babru kodër.
19	Facebook	18/03/2021	Elisa Spiropali	Përmbajtja E ardhmja i përket atyre! Me të rinj të talentuar të Kamzës që i bashkohen fitores 🤝 për një Shqipëri Aledhe më të mirë.  S'ka kohë për pushim. S'ka kohë për kthim.

				Shqipëria e ardhmja jonë. Audienca e synuar janë të rinjtë dhe të rejat e zonës elektorale të kandidatës së partisë socialiste.
20	Facebook	19/03/2021	Elisa Spiropali	Përmbajtja Për të gjithë ata që e nisin ditën duke shijuar një briosh të mirë, ta dini se ai është përgatitur nga Zonjushat duararta të pastiçeri “Dolce & Salato” pranë Shkollës Profesionale në Kamëz. Prej 5 vitesh, kjo punishte shpërndan ëmbëlsira për Hotele, Restorante dhe Bar-e të njohura në të gjithë Shqipërinë. Audienca e synuar: janë Biznesmenët e zonës elektorale të kandidatës së partisë socialiste në Kamzë.
21	Facebook	19/03/2021	Elisa Spiropali	<input type="checkbox"/> 0 tatim fitimi dhe 0 TVSH për biznesin e vogël deri në vitin 2029.  Me bizneset e lagjes së Shkollës Profesionale diskutuam mbi ndihmën që ka dhënë ulja e taksave kombëtare dhe tarifave lokale, si dhe çlirimin nga presioni i një pushteti lokal abuziv dhe të dhunshëm. Po ashtu kantieret e investimeve në Kamëz po i rrisin vlerën zonës dhe sipërmarrjes.  <input type="checkbox"/> Falë reformimit kapilar të sistemit, sot mbi 100 mijë biznese te vogla paguajnë 0 tatim fitimi, ndërsa 97% e qytetarëve të punësuar fitojnë më shumë falë taksimit progresiv.

				<p>#ShqipëriaeArdhmjaJonë AL #VotoPS12 #ElisaSpiropali_9 🗳️</p> <p>#KrenarepërKamzën Audienca e synuar janë Biznesmenët e Zonës elektorale të kandidatës së partisë socialiste Kamzë.</p>
22	Facebook	19/03/2021	Elisa Spiropali	<p>Përmbajtja: Në çdo lagje të Kamzës ndjej mbështetjen e madhe që na japin gratë dhe vajzat. Nuk do i zhgënjejme kurrë. Po bëjmë dhe do bëjmë për fëmijët e tyre më shumë seç është bërë në 30 vite marrë bashkë.</p> <p>#ShqipëriaeArdhmjaJonë 💖 Audienca e synuar: janë të gratë dhe vajzat e zonës elektorale të kandidatës së partisë socialiste Kamzë.</p>
23	Facebook	19/03/2021	Elisa Spiropali	<p>Përmbajtja: 🗳️ Shkolla “Ibrahim Rrugova” 🏠 – Dita e dytë e vaksinimit të mësuesve në Kamzë. Deri ditën e diel do të vaksinohen në total 1000 mësues nga 6120 të tillë në të gjithë vendin.</p> <p>Lufta jonë për shëndetin është mbi çdo betejë elektorale.</p> <p>#ShqipëriaBuzëqesh 🌸</p>

				<p>#ShqipëriaeArdhmjaJonë AL</p> <p>#SkaKohëPërPushim 🚧♂</p> <p>Audienca e synuar: janë mësues dhe mësuese të Kamzës, dhe zonave elektorale të kandidatës së partisë socialiste.</p>
24	Facebook	19/03/2021	Elisa Spiropali	<p>Përmbajtja:</p> <p>Valias i Vjetër 🏠 Për vizitë në shtëpinë e Xhemal Selës, banesa e të cilit dëmtuar nga tërmeti duke u klasifikuar në kategorinë DS1. Xhemali ka përfituar nga fondi i dëmshpërblimit duke i kryer në kohë dhe me kujdes riparimet e banesës së tij.</p> <p>#SiNjëFamilje ❤️</p> <p>Audienca e synuar: janë banorët e Valiasit dhe të zonave të tjera elektorale të kandidatës së partisë socialiste.</p>
25	Facebook	19/03/2021	Elisa Spiropali	<p>Përmbajtja:</p> <p>Në çdo lagje 🏠</p> <p>Gratë e Valiasit dhe Kamzës së Re na dhanë besim që e ardhmja nuk ndalet 📖</p> <p>Audienca e synuar:</p> <p>Janë gratë dhe vajzat e zonës elektorale të Valiasit dhe të Kamzës së re.</p>
26	Facebook	19/03/2021	Elisa Spiropali	<p>Përmbajtja:</p> <p>Të rinjtë dhe pensionistët e Valiasit dhe Kamzës së re janë njësoj entuziastë për</p>

				<p>ndryshimet e mëdha infrastrukturore të zonës.  Nuk ndalemi 🗨️  #ShqipëriaeArdhmjaJone 🗨️  Audiencia e synuar:  Janë të rinjtë dhe pensionistët e Valiasit dhe Kamzës së re.</p>
27	Facebook	20/03/2021	Elisa Spiropali	<p>Përmbajtja:  Babrru Qendër 🗨️ Me kryefamiljarët dhe gratë e kësaj zone bashkëbiseduam mbi Planin e Veprimit 2021-2025 me Edi Ramën dhe Partinë Socialiste.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Përfundojmë vaksinimin e të gjithë popullësisë brenda pranverës së 2022-it.</li> <li>● Rrisim pagën minimale në 40 mijë lekë brenda mandatit të tretë qeverisë.</li> <li>● Zero taksa për pagat deri në 40 mijë lekë dhe ulim taksat për pagat deri në 250 mijë lekë, nga Janari i 2021-it.</li> <li>● Zero Tatim Fitim dhe Zero Tvsh për biznesin e vogël deri në 2029-tën.</li> </ul> <p>#ShqipëriaeArdhmjaJonë AL  #SkaKohëpërPushim 🗨️  #VotoPS #ElisaSpiropali_9 🗨️  Audiencia e synuar:</p>

				janë kryefamiljarët dhe gratë e Babru qendër. Dhe e zonave elektorale të kandidatës së partisë socialiste.
28	Facebook	16/03/2021	Elisa Spiropali ceb	Përmbajtja: Surpriza më e bukur nga gra dhe vajza të Laknasit dhe Valiasit 🙏❤️ Audiencia e synuar: Janë gra dhe vajza të Laknasit dhe Valiasit.
29	Facebook	10/03/2021	LSI kamëz	Përmbajtja: 🙏 Në Kamëz ku çdo ditë të rinj dhe të reja i bashkohen ekipit tonë! RINIA DO TA NDËSHKOJË MODELIN E VJETËR TË VJEDHJES, SHPOPULLIMIT TË SHQIPËRISË DHE PROPAGANDËS 3D! Forca ekipit të Bathores bashkë me Besin , Blerionin , Elidonin, Liianen, Leonisen, Mentorin 🙏 #shqipëria_shtëpia_juaj🙏 Audiencia e synuar: janë të rinj dhe të reja të Bashkisë Kamzë.
30	Facebook	11/03/2021	LSI Kamëz	Përmbajtja: TE BINDUR PER NDRYSHIM PUNA VAZHDON NE EKIPIN E BATHORES Audiencia e synuar: janë banorë të Kamzës, që zyrat janë gjithmonë duke punuar.
31	Facebook	15/03/2021	LSI Kamzë	Përmbajtja: Për rininë e Shqipërisë, e ardhmja fillon me largimin e se keqes

				<p>ME BUZËQESHJET DHE ENERGJINË RREZATUESE, TË RINJTË E BATHORES JU FTOJNË EDHE JU TË BASHKOHENI!</p> <p>25 PRILLI DITA E NDESHKIMIT AL Audiencia e synuar janë të rinjtë dhe të rejtat e zonës elektorale të Kamzës.</p>
32	Facebook	16/03/2021	LSI kamzë	<p>Përmbajtja: Te bashkuar dhe te motivuar rinia e Bathores gati per ndryshimin e 25 Prillit Audiencia e synuar: janë të rinjtë dhe të rejtat e zonës elektorale të Bathores.</p>
33	Facebook	16/03/2021	LSI Kamzë	<p>Përmbajtja: KAMZA E VENDOSUR PER RROTACIONIN POLITIK. AS QARJET FALLSO, FJALIMET E BUKURA, APO PRESIONI I MODERUAR NUK NDRYSHOJNE REALITETIN E HIDHUR QE KA MBULUAR TE GJITHE SHQIPTARET Audiencia e synuar: Janë banorët e zonës elektorale të Kamzës.</p>

### 3. Parregullsitë e vëzhguara

Të gjitha raportet e incidenteve duhet ti bashkëngjiten këtij raporti.

<b>Neni</b>	<b>Parregullsia</b>	<b>Data e Raportimit të Parregullsisë tek KQZ-ja</b>	<b>Raporti i incidentit i bashkëngjitur</b>
Neni 78, pika 6	Fushata zgjedhore në një institucion publik	-	Po/Jo
Neni 78, pika 7	Subjektet zgjedhorë/kandidatët i ofrojnë ose japin para, të mira materiale, premtojnë vende pune ose favore të tjera, votuesve ose personave të tjerë që kanë lidhje me të, me qëllimin e marrjes së nënshkrimit për emërimin e një kandidati për zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votim, ose në këmbim të angazhimit në aktivitete jo ligjore për të mbështetur një kandidat ose një parti politike.	-	Po/Jo
Neni 78, pika 9	Subjekti zgjedhor/Kandidati që organizon ose mbulon shpenzimet për koncert, ngjarje kulturore dhe argëtuese ose aktivitete bamirësie.	-	Po/Jo
Neni 78, pika 10	Subjekti zgjedhor/Kandidati që ofron artikuj ose materiale të printuara me vlerë prej më shumë se 5 (pesë) qind Lekë për artikull ose material.	-	Po/Jo
Neni 79, pika 2	Paraqitja e materialeve propagandistike statike më shumë se 5 metra nga zyra elektorale	-	Po/Jo
Neni 2, udhëzim nr.1 datë 31.05.2017, i KQZ-së	Më shumë se një zyrë elektorale për lagje/fshat	-	Po/Jo
Neni 79, pika 3	Mos përfshirja e deklaratës së autorizimit në materialet vizive të fushatës propagandistike	-	Po/Jo



--	--	--	--